

VENDIM
Nr. 54, datë 28.10.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 47, DATË 13.6.2018, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
DIBËR", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 47, datë 13.6.2018, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Dibër'", i ndryshuar,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Dibër (UK Dibër), me shkresën nr. 665 prot., datë 30.9.2019, me lëndë "Përcjellje e dokumenteve të nevojshëm për ndryshimin e drejtuesit teknik" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Dibër për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Dibër me vendimin nr. 47, datë 13.6.2018, "Për licencimin e sh. a. Ujësjellës-Kanalizime Dibër", i ndryshuar, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Dibër sh.a., z. Elvis Manga, zotëron diplomë Bachelor në "Inxhinieri ndërtimi; marrë në tetor 2017.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Dibër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Dibër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 47, datë 13.6.2018 "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Dibër", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

"Drejtues teknik z. Elvis Manga".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani